- Inxhinier Ndërtimi Profili Konstruktor/Strukturist	1 (një)
- Inxhinier Mekanik	1 (një)
- Inxhinier Elektrik	1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
- Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder	1 (një)
- Inxhinier Mjedisi	1 (një)

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e operatorit ekonomik ofertues.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë :

- Kontratë punë noteriale e vlefshme
- Diploma

Secili prej drejtuesve teknik të mësipërm, duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimalisht 3 (tre) muajt e fundit.

Përsa i përket Inxhinierit Mekanik duhet të jetë i pajisur me :

- Çertifikatë për Sistemet Ngrohje-Ftohje, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të liçencuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Për 1 (një) prej drejtuesve teknik të mësipërm të shoqërisë duhet të paraqitet edhe :

- “Certifikatë e Audituesit Energjistik” në ndërtesa, lëshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë në përputhje me VKM Nr. 407 datë 19.06.2019.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Në rastin konkret synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë staf të kualifikuar teknik për kryerjen e punimeve objekt kontrate.

Në nenin 8 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” parashikohet se “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.” Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me materiale dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t'u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit.”

Sa më sipër, në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierëve të mësipërm, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme e tyre, porë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, dhe referuar volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, si dhe në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e saj, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme .

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

*Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të*

cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafi i inxhinierëve, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit i Profilit Strukturist/Konstruktor** kërkohet për zbatimin e saktë të punimeve strukturore të objektit. Duke qenë se në preventiv është parashikuar të bëhet prishja e disa mureve ekzistues, në mënyrë që të bëhet i mundur bashkimi i dy ambjenteve për tu adaptuar në palester dhe prishja e disa mureve perimetrale në mënyrë që të bëhet dalja e shkallëve të emergjencës për secilin kat është e domosdoshme ekspertiza e një inxhinieri konstruktor, duke marrë parasysh që objekti nuk është i ri dhe muret e gurit janë gjithashtu dhe mure mbajtëse. Në mënyrë që prishja e mureve ekzistues të mos ketë ndikim në strukturat mbajtëse të objektit është parashikuar që të bëhet zëvendësimi me konstruksion metalik dhe struktura b/a sipas nevojës. Inxhinieri konstruktor është i nevojshëm edhe për ndërtimin dhe implementimin e shkallëve të emergjencës të cilat do të jenë prej konstruksioni metalik.
- **Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, ku përfshihet komplet sistemi i ngrohjes dhe sistemi i mbrojtjes ndaj zjarrit MNZ sipas parashikimeve në projektin mekanik.
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike, pasi referuar projektit dhe preventivit të punimeve të zbatimit, do të kryhen instalime elektrike, do të kemi ndryshime linjash elektrike dhe ndryshim ndriçimi në të gjithë ambientet e objektit të ri, të cilat kërkojnë detyrimisht mbikqyrjen nga inxhinieri elektrik gjatë periudhës të zbatimit të punimeve.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidraulike duke përfshirë furnizimin dhe vendosjen e tubave dhe rakorderive, pajisjeve hidrosanitare (WC, lavaman, rubineteri etj), furnizimin e ujit sanitar, sistemin e KUZ dhe shkarkimeve, lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventivin, sipas parashikimeve në projekt.
- **Inxhinieri Gjeodet/Topograf/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve gjeodezike duke përfshirë punime si piketimi, rlevime të ndryshme topografike në sisteme koordinative të ndryshme caktimi i kuotave të kërkuara nga projekti, azhornime të ndryshme, persa i perket sistemimit të terreneve të jashtme.
- **Inxhinieri i Mjedisit** është përgjegjës për zbatimin e zërave të preventivit ku kemi të bëjmë me punime të jashtme dhe gjelberimi si mbjellje bari dhe pemë dekorative, vendosje stolash dekorativ, rrethimi me zgara hekuri me figuracion dekorativ, dhe punime gjermimi, ndërtimi i terreneve të jashtme, heqje dherash etj, që kanë ndikim negativ në mjedisin përreth. Gjatë zbatimit të projektit në realizimin e plotë të kontratës, është e pashmangshme që në realizimin e punimeve të ketë

mbeturina e inerte të cilat janë të një rrezikshmërie të lartë për komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet të realizohet në përpikmëri dhe në kohë reale.

Përsa i përket Inxhinierit Mekanik duhet të jetë i pajisur me :

- Çertifikatë për Sistemet Ngrohje-Ftohje, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

** Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesin e kerkuar si me siper, emer/mbiemer, numrin dhe datën e certifikates, si dhe institucionin që ka lëshuar kete dokument.*

Argumentimi: Duke qenë se një pjesë të konsiderueshme të punimeve mekanike e zë sistemi i ngrohjes, është e domosdoshme që Drejtuesi Teknik që do të ndjekë këto procese të jetë i specializuar dhe i profilizuar përsa i përket kondicionimit dhe sistemeve ngrohje-ftohje, pasi gama e profilit të inxhinierëve mekanik është e larmishme dhe nuk kufizohet vetëm tek sistemet HVAC, por edhe tek industritë prodhuese, automekanika, makineritë lëvizëse etj.

- **Përsa i përket inxhinierit të pajisur me** “Certifikatë e Audituesit Energjitik” në ndërtesa, lëshuar nga Agjencia për Eficiencën e Energjisë në përputhje me VKM Nr. 407 datë 19.06.2019.

Argumentimi : Kërkesa e shkronjës e) është vendosur në përmbushje të përcaktimeve të nenit 16, pika 5, gërma “b” të ligjit nr. 124/2015 “Për eficiencën e energjisë” i ndryshuar, ku parashikohet se “Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen :

- çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo **i nënshtrihen një rinovimi të konsiderueshëm**”, si dhe bazuar në VKM nr. 407, datë 19.06.2019 “Për miratimin e procedurës, të kategorive, kushteve, kërkesave të kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet Certifikata e Audituesit Energjitik”, ku parashikohet se: a) “Certifikatë e audituesit energjetik”, certifikata e lëshuar nga Agjencia për Eficiencën e Energjisë (AEE), që vërteton kryerjen e testimit të njohurive për auditimin e energjisë në ndërtesa dhe industri.

Referuar projektit dhe preventivit të punimeve të zbatimit, do të kryhen punime të cilat lidhen me eficiencën e energjisë si sistemi i ngrohjes, qarkullimi i ajrit, izolimi akustik, hidrik dhe termik jemi në kushtet që disponueshmëria e një auditesi energjie në bazë të VKM Nr. 407 datë 19.06.2019, është i domosdoshëm.

Për objektin konkret, në fazën e projektimit nuk është hartuar raporti paraprak i eficiencës së energjisë dhe rrjedhimisht është i domosdoshëm Audituesi i Energjisë në fazën e zbatimit.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë) si dhe të jenë në listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit, si më poshtë:

- Inxhinier Telekomunikacioni/IT/Elektronik 1 (një)
- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)

Për secilin duhet të paraqiten :

- Kontratë punë e vlefshme
- Diploma

Përsa i përket Inxhinierit Telekomunikacion/IT/Elektronik duhet të jetë i pajisur me :

- Certifikatë për “CCNA Routing and Switching” ose ekuivalent (*për ndërlidhjen e pajisjeve të rrjetit Kompjuterik dhe Telekomunikacionit*), e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të licencuara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- **Inxhinier Telekomunikacioni/IT/Elektronik** Kjo certifikatë kërkohet kur ka punime në rrjetin e internetit, rrjetin IT, punimet e telefonisë, drejtimi, lidhja dhe konfigurimi i këtyre rrjeteve. Më konkretisht nëpërmjet këtij kualifikimi vërtetohen njohuritë dhe aftësitë që nevojiten për të instaluar, konfiguruar, operuar dhe zgjidhur një rrjet ndërmarrjesh të vogla dhe të mesme, sic kërkohet dhe në preventivin e punimeve.

Argumentimi: *Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.*

Kjo certifikatë kërkohet kur ka punime në rrjetin e internetit, rrjetin IT, punimet e telefonisë, drejtimi, lidhja dhe konfigurimi i këtyre rrjeteve. Më konkretisht nëpërmjet këtij kualifikimi vërtetohen njohuritë dhe aftësitë që nevojiten për të instaluar, konfiguruar, operuar dhe zgjidhur një rrjet ndërmarrjesh të vogla dhe të mesme, siç kërkohet dhe në preventivin e punimeve.

Në interpretim të dispozitave të mësipërme, zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga personat të pajisur me licencë të cilët njëherazi mbajnë përgjegjësi për realizimin e punimeve në përputhje me kushtet e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierëve të mësipërm, njësia e prokurimit gjykon se për sa kohë që autoriteti kontraktor në preventivin e punimeve ka parashikuar punime të një natyre në të cilën shfaqet e nevojshme prania e tyre, parë kjo në raport edhe me pikat dhe kategoritë përkatëse të licencës së kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, dhe referuar volumeve të punimeve të parashikuara në preventivin dhe në projektin përkatës, kriteri i mësipërm është në përputhje dhe proporcion me volumin e kontratës, si dhe në raport me kohëzgjatjen e zbatimit të punimeve të parashikuar, vlerën dhe natyrën e saj, është një kërkesë në përpjestim me natyrën dhe objektin e punimeve dhe nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është i nevojshëm pasi duke analizuar dhe objektin e prokurimit i cila është “Rikonstruksion i shkollë 9 vjeçare Kamber Bënja”, prezenca e tij në kantier lidhet drejtëpërdrejtë me zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë

19.05.2021, **i ndryshuar** , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesat e subjektit, punonjësit specialistë të kualifikuar, si më poshtë:

Nr	EMERTIMI	
1	Teknik ndërtimi	(2 persona)
2	Teknik mekanik	(1 person)
3	Teknik topograf /gjeodet / gjeometer	(1 person)
4	Teknik elektrik	(1 person)
5	Karpentier	(2 persona)
6	Hekurkthyes	(1 persona)
7	Hekurpunues	(1 person)
8	Murator/Suvatues	(4 persona)
9	Pllakashtrues	(3 persona)
10	Hidroizolues	(2 persona)
11	Termoizolues	(1 person)
12	Specialist parketi	(1 person)
13	Specialist për veshje fasade	(2 persona)
14	Bojaxhinj	(4 persona)
15	Saldator	(2 persona)
16	Përgatitës të konstruksioneve metalike	(1 person)
17	Elektracist	(3 persona)
18	Hidraulik	(2 persona)
19	Specialist gipsi	(3 persona)
20	Marangoz/Mobilier	(2 persona)
21	Specialist për sisteme ngrohje-ftohje	(3 persona)
22	Teknik /specialist elektronik/IT	(1 person)
	Totali 43 (dyzetë e tre) punonjës	

Për punonjësit me profesionet si më sipër cituar, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit, operatorët ekonomik ofertues duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë tabelën e mëposhtme me të dhënat e sakta që i përkojnë diplomës/certifikatës së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetore, të cilat regjistrohen në bazën e të dhënave të AKPA-së pranë Ministrisë së Financave (Institucioni përgjegjës për formimin profesional).

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzës/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
etj					

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratën individuale të punës;
- Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (çertifikatë/dëshmi), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të liçencuara /akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë.”

(Per teknikët duhet të paraqitet minimalisht diploma ose dëftesa e përfundimit të shkollës së mesme profesionale).

- Dëshmi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI ose nga një trup çertifikuese e akredituar në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr.8734, datë 01.02.2001 dhe Ligjit Nr. 13/2013.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi : Kërkesat e germës c) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Tekniku i Mesëm Ndërtimit** është i nevojshem për ndjekjen e realizimin e punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivave të punimeve. Kërkesa e AK për 2 (dy) Teknike Ndërtimi vjen pasi objekti i prokurimit do të jetë i shtrirë në dy fronte njëkohësisht (rikonstruksioni i godinës dhe sistemimet e jashtme), dhe për këtë arsye duhet prania e dy punonjësve të tillë.
- **Tekniku Mesëm Mekanik** është i nevojshem për ndjekjen e zbatimin e projektit mekanik, për realizimin e sistemit të ngrohjes, sistemin MNZ dhe furnizimin me ujë të ngrohte.
- **Tekniku i mesëm topograf /gjeodet / gjeometer** është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të sistemit të jashtëm, sepse kemi punime të cilat kërkojnë precizion në kuota dhe nivele të caktuara ku duhen montuar strukturat apo elementet e ndryshëm dhe ata duhet të lexojnë projektin dhe kryejnë matjet e nevojshme.
- **Tekniku Mesëm Elektrik** është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve dhe instalimeve elektrike, për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses.
- **Karpentier 2 (dy)** janë të nevojshëm pasi në zërat e preventivit përfshihen punime betoni, kallëpet, shtresat dhe hekuri periodik ndërtimi, montimi i skelave për punimet në lartësi etj.

Duke qënë se shkolla ka sipërfaqje të madhe ndërtimi, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa për disponimin nga ana e ofertuesve për 2 (dy) karpentierëve, është në përputhje me objektin e kontratës si dhe i shërben qëllimit të AK duke garantuar këtë të fundit për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

- **Hekurkthyes 1 (një)** janë të nevojshëm pasi në zerat e preventivit përfshihen përpunimi dhe lidhja e hekurit të ndërtimit.
- **Hekurpunues 1 (një)** është i nevojshëm për rrahjen dhe punimin e hekurit për realizimin e zgarave dekorative me figuracion mesatar për rrethim muri.
- **Murator/Suvatues 4 (katër)** janë të nevojshëm për kryerjen e punimeve të muraturës dhe suvatimeve në tavan dhe mure sipas zërave të preventivave të punimeve.

Lidhur me kërkesën e mësipërme, njësia e prokurimit argumenton se duke analizuar preventivin e punimeve, për rikonstruksionin e shkollës janë parashikuar punime të cilat kërkohet domosdoshmërisht prania e pllakashtruesve.

Në seksionin I. PUNIME MURATURE DHE BETONI

Mur me tulla me 6 bima, $t=12\text{cm}$, $h\sim 3\text{m}$, llaç perzier M15 në sasinë 15 m^3 , rreth 200 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në seksionin III. PUNIME SUVATIMI DHE VESHJE

Suva solete $h\sim 4\text{m}$ me drejtues, me krah në sasinë 1140 m^2 , rreth 3397.2 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Suva brenda mur tulle $h\sim 4\text{m}$ me krah, llaç perzier M 25 në sasinë 3300 m^2 , rreth 3283.5 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

2.308a Suvatim me grafiato $h > 4\text{m}$ (pjesë pa kapot + paturat) në sasinë 95 m^2 , rreth 343.9 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në total 7 224.6 orë pune gjithsej për punime që nevojitet domosdoshmërisht prania e muratorit/suvatuesit.

Duke qënë se punimet e muraturës dhe suvatimeve në tavan suvatim brenda, suvatim me grafiato janë në volume të mëdha si më sipër listuar, si dhe referuar orëve të punëve për këtë kategori punimesh ku është relativisht e madhe dhe konkretisht 7 224.6orë pune, njësia e prokurimit gjykon se kë kërkuar një numër minimal punonjësish, duke garantuar autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 4 (katër) punonjës **Murator/Suvatues**.

- **Pllakashtrues 3 (tre)** janë të nevojshëm për shtrimet e dyshemeve me pllaka graniti, mermeri, qeramike dhe porcelani, si dhe veshjen e tualeteve me pllaka qeramike.

Lidhur me kërkesën e mësipërme, njësia e prokurimit argumenton se duke analizuar preventivin e punimeve, për rikonstruksionin e shkollës janë parashikuar punime të cilat kërkohet domosdoshmërisht prania e pllakashtruesve.

Në seksionin për Punime shtresash janë parashikuar punime si :

Shtresë me pllaka grez porcelanato ne klasa, laboratore, zyra ngjitur me kolle në sasinë 1740 m², rreth 3480 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Shtresë me pllake mermeri t=2cm Janina dritare+shkalle dhe sheshpushime në sasinë 18.5 m², rreth 58.09 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Shtresë me pllake mermeri t=2cm Janina (shkallët e brendshme) në sasinë 52.6 m², rreth 165.16 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Shtresë me pllake mermeri t=2cm Janina (pragjet e dritareve) në sasinë 129.6 m², rreth 406.94 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në seksionin Për punime suvatimi dhe veshje janë parashikuar punime si :

Veshje me pllake majolike (muret e nyjeve sanitare) në sasinë 280 m², rreth 1 036 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Plintus me pllaka mermeri ne shkalle në sasinë 65 ml, rreth 70.85 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

2.324/b Plintuse grez importi, h = 10 cm ne shkalle në sasinë 1350 ml, rreth 472.5 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në seksionin Punime per sisteme te jashtme janë parashikuar punime si :

Pllakë gur në sasinë 610 m², rreth 915 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në total 6 604.54 orë pune gjithsej për punime të cilët nevojitet prania e pllakashtruesve.

Duke qënë se punimet për shtrimin e pllakave graniti, mermeri, pllaka majolike janë në volume të mëdha si më sipër listuar, si dhe referuar orëve të punëve për këtë kategori punimesh ku është relativisht e madhe dhe konkretisht 6 604.54 orë pune, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish, duke garantuar autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 3 (tre) punonjës pllakashtrues.

- **Hidroizolues 2 (dy)** janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të hidro-izolimit në dysHEME dhe nyjet sanitare, me materialin e duhur sipas zërave të preventivave të punimeve.

Lidhur me kërkesën e mësipërme, njësia e prokurimit argumenton se duke analizuar preventivin e punimeve, në seksionin punime shtresash për rikonstruksionin e shkollës, është parashikuar zëri Hidroizolim me emulsion dhe dy duar bitum (kati përdhe) në sasinë 612 m², rreth 257.04 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Si dhe zëri Hidroizolim në nyje sanitare me dy shtresa mapej në sasinë 155 m², rreth 100.75 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në seksionin punime çatie dhe tarrace, është parashikuar zëri FV membrane ajrosese antiavulluese në sasinë 841 m², rreth 252.3 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në total 610.09 orë pune gjithsej për punime hidroizolimi.

Bazuar në grafikun e punimeve, seksioni punime shtresash është parashikuar të kryhet në 9 javë. Në këtë seksion janë hartuar 10 zëra të ndryshëm, dhe në ndarjen e këtyre zërave për zbatimin me sukses të tyre, njësia e prokurimit gjykon se për zërat hidroizolim janë të mjaftueshëm 1 muaj e gjys punë.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se ;

26 ditë pune në muaj x 8 orë pune në ditë = 208 orë pune në total për një muaj, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

Duke qënë se punimet për hidroizolim do të kryhen për 1 (një) muaj e gjys (sipas grafikut të punimeve) për rikonstruksionin e shkollës dhe për amjentin ndihmës, atëherë nevojiten 208 orë pune.

610.09 orë pune (për punimet hidroizolimi) : 314 orë totali për 1 (një) muaj = 1.9 punonjës hidroizolues të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 2 (dy) punonjës hidroizolues.

- **Termoizolues 1 (një)** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të termoizolimit si vendosja e shtresës termoizoluese në çati.
- **Specialiste parketi 1 (një)** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të shtrimit të dyshemesë me parket druri.
- **Specialist për veshje fasade 2 (dy)** janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të veshjes së fasadës me polisterol për termoizolim e objektit.

Konkretisht, për rikonstruksionin e shkollës në zërin e preventivit tek seksioni punime çatie dhe tarrace Shtresë termoizoluese me polisterol t=5 cm në sasinë 841 m², rreth 168.2 orë punë të nevojshme për

kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1). Në grafik është parashikuar kryerja e këtyre punimeve për 5 javë kalendarik

Në preventiv, Për punime suvatimi dhe veshje është parashikuar zëri veshje fasade me polisterol t=cm zjarrdurues + kollë + rrjetë + suva (paketë e plotë) në sasinë 1450 m², rreth 9 178.5 orë pune të nevojshme. Në grafikun e punimeve ky zë është parashikuar të kryhet për 2 muaj e gjys.

Duke qënë se çatia ka një sipërfaqje të madhe dhe konkretisht 841 m², njësia e prokurimit gjykon se disponimi i 2 (dy) Specialistëve për veshje fasade garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë.

- **Bojaxhinj 4 (katër)** janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të lyerjeve të brendshme dhe fasadës, sipas zërave të preventivave të punimeve.

Duke marrë në konsideratë faktin se punimet e lyerjes së shkollës nuk mund të kryhet gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës (e cila është 7 muaj) për shkak se është procesi i fundit që kryhet në përfundimin e një rikonstruksioni, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish bojaxhinj. (sipas grafikut të punimeve) ky proces është parashikuar të kryhet në 9 javë, dhe për rrjedhojë llogaritja e numrit të punonjësve nga AK për bojaxhinj është bërë për këtë periudhë kohe të sipërcituar.

Konkretisht, në seksionin Punime Bojatisje janë parashikuar punime lyerje tek preventivi i punimeve zëri Bojë hidroplastike importi cilësia 1 (fasadat e jashtme) në sasinë 1545 m², rreth 556.2 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1), si dhe Bojë hidroplastike importi cilësi 1 (tavanet) në sasinë 1670 m², rreth 601.2 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Bojë hidroplastike importi cilësi 1 (muret e brendshme) në sasinë 3750 m², rreth 1 350 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Nga mbledhja e orëve të punës për lyerjen e shkollës, në total janë **2 507.4** orë pune për përfundimin e punimeve me sukses.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se ;

26 ditë pune në muaj x 8 orë pune në ditë = 208 orë pune në total për një muaj, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

Duke qënë se punimet për lyerje do të kryhen për 2 (dy) muaj e 1 javë, atëherë nevojiten 450 orë pune.

2 507.4 orë pune (për punimet lyerje/bojatisje) : 450 orë totali për 1 (një) muaj e gjys = 5.5 punonjës bojaxhinj të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 4 (katër) punonjës bojaxhinj.

- **Saldator 2 (dy)** janë të nevojshëm për saldimin, drejtimin, bashkimin e detaleve të ndryshëm, me prerjen e tyre, me bashkimin e objekteve të madhësive dhe formave të ndryshme duke përdorur mjetet dhe pajisjet e duhura, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Përgatitës të konstruksioneve metalike 1 (një)** është i nevojshëm për përpunimin, prerjen, bashkimin dhe montimin e elementeve metalik, në konstruksione prej metali si shkalla e emergjencës.
- **Elektricit 3 (tre)** janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve dhe instalimeve elektrike, sipas zërave të preventivave të punimeve.

Duke marrë në konsideratë faktin se punimet elektrike do të kryhen në muajin e tretë (sipas grafikut të punimeve), njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish elektrik.

Konkretisht, vetëm për muajin e tretë janë parashikuar punime elektrike 8 253.82 orë punë (sipas tabelës nr 1).

Duke marrë në konsideratë dhe Cmontimin e rrjetit elektrik ekzistues rreth 105 orë pune, në total janë 8 253.82 orë pune për punime elektrike (pa pasur në kosideratë edhe pajisjet elektrike)

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se ;

26 ditë pune në muaj x 8 orë pune në ditë = 208 orë pune në total për një muaj, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

Duke qenë se punimet elektrike do të zgjasin për 11 javë sipas grafikut të punimeve, dhe rreth 1 javë për çmontimin e rrjetit elektrik, totali rreth 3 muaj, e përkthyer në orë pune 624 orë

8 253.82 orë pune (për punimet elektrike) : 624 orë totali në muaj = 13 punonjës elektricit të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses brenda 1 muaji.

Njësia e prokurimit gjykon se këto punime mund të ecin paralelisht me punimet e tjera dhe mund të shtrihen në kohë, duke caktuar një numër racional punonjësish elektrik si dhe duke iu ardhur në ndihmë operatorëve ekonomik ofertues në përmbushje të kriterit të mësipërm.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se katër punonjës janë të mjaftueshëm për punime elektrike, duke përcaktuar 1 teknik elektrik si dhe 3 elektricit të pajisur me dëshmi të sigurimit teknik.

Nga përlllogaritja e mësipërme, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish me dëshmi kualifikimi për elektrik, duke garantuar autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

- **Hidraulike 2 (dy)** janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivave të punimeve.

Duke marrë në konsideratë faktin se punimet hidraulike do të kryhen në rreth 1 muaj (sipas grafikut të punimeve), njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësish hidraulik.

Konkretisht, për 3 javë janë parashikuar punime hidraulike 404.95 orë punë në seksionin Sistemet e shkarkimit të ujrave të zeza të shkollës (sipas tabelës nr 1).

Akoma më tej, në preventivin e punimeve janë parashikuar edhe punime hidrosanitare 62.85 orë pune për 1 javë, si dhe punime rrjeti i shpërndarjes së ujit sanitar 564.25 orë pune për 3 javë.

Në total janë 1 032.05 orë pune për punime hidraulike dhe sistemi i shkarkimit të ujrave të zeza, për 2 muaj të parashikuar në grafikut të punimeve.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se ;

26 ditë pune në muaj x 8 orë pune në ditë = 208 orë pune në total për një muaj, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

Duke qënë se punimet hidraulike janë 2 muaj, atëherë duhen të kryhen në 416 orë pune

1 032.05 orë pune (për punimet hidraulike) : 416 orë totali për 2 javë = 2.4 punonjës hidraulik të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 2 (dy) punonjës hidraulik.

- **Specialist gipsi 3 (tre)** janë të nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të sistemeve të thata si realizimi i tavaneve me kartonxhes, sipas zërave të preventivave të punimeve.

Duke marrë në konsideratë faktin se punimet e gipsit, do të kryhen (sipas grafikut të punimeve të cilësuara si punime ndërtimi) gjithsej 2 muaj e gjys, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal për punonjësish specialistë gipsi.

Konkretisht, në zërin e preventivit seksioni për punime suvatimi dhe veshje është parashikuar zëri Tavan me kartonxhes (kati i dytë) në sasinë 575 m², rreth 1 207.5 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1), si dhe tavan i varur me pllaka gipsi në sasinë 400 m², rreth 436 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1)

Në total janë 1643.5 orë pune për punime gipsi, si Tavan me kartonxhes, dhe tavan i varur me pllaka gipsi.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se ;

26 ditë pune në muaj x 8 orë pune në ditë = 208 orë pune në total për një muaj, (duke hequr ditët e pushimit sipas kodit të punës së Republikës së Shqipërisë, dhe duke lënë orët maksimale të punës).

208 orë pune në total për një muaj x 2.5 muaj (që nevojiten këto punime të kryhen sipas grafikut të punimeve) = 520 orë punë (në dispozicioni për kryerjen e këtyre punimeve).

1643.5 orë pune (për punimet e gipsit) : 520 orë pune për 2.5 muaj = 3.1 punonjës Specialist gipsi të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses.

Nga përlllogaritja e mësipërme, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër të domosdosshëm punonjësit me dëshmi kualifikimi për specialist gipsi, duke garantuar autoritetit kontraktor që punimet e gipsit si psh Tavan me kartonxhes, të zbatohen me sukses.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 3 (tre) punonjës specialist gipsi.

- **Marangoz/Mobilier 2 (dy)** janë të nevojshëm për realizimin e vendosjes së dyerve të brendshme, strukturës së çatisë, dhe shiritit MDF në muret e klasave, sipas zërave të preventivit, tavani i drurit etj.

Duke marrë në konsideratë faktin se punimet e drurit do të kryhen në javën e katërt dhe të pestë, dhe javën e tetë dhe të nëntë (sipas grafikut të punimeve) dmth gjithsej 1 muaj, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal për punonjësish specialistë Marangoz ose Mobilier.

Konkretisht, në zërin e preventivit për punime shtresash është parashikuar zëri Shtresë parketi për palestër në sasinë 100 m², rreth 523 orë punë të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Si dhe në zërin e preventivit seksioni për punime suvatimi dhe veshje është parashikuar zëri F + V shirit druri në muret e klasave a=15cm në lartësinë e bankave në sasinë 1350 ml, rreth 675 orë pune të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Si dhe në zërin e preventivit seksioni për punime Çatie dhe Tarrace, është parashikuar me nr anal 2.279 Shtresë dërrasa FM 2.5cm në sasinë 841 m², rreth 1 345.6 orë pune të nevojshme për kryerjen e këtij zëri (sipas tabelës nr 1).

Në total janë 2 543.6 orë pune për punime të drurit, si parket, shirit druri në muret e klasave dhe shtresë dërrase FM 2.5 cm.

Nga një përlllogaritje e thjeshtë vërehet se ;

Duke qënë se punimet e drurit nuk janë të përcaktuar konkretisht në grafikun e punimeve për secilin zë, njësia e prokurimit gjykon se referuar orëve të punëve për këtë kategori që është relativisht e madhe dhe konkretisht 2 543.6 orë pune dhe shtrirjen e tyre në kohë në 2 ose 3 muaj, nevojiten minimumi 2 (dy) punonjës për të garantuar zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Nga përlllogaritja e mësipërme, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësit me dëshmi kualifikimi për specialist Marangoz ose Mobilier, duke garantuar autoritetit kontraktor që punimet e drurit si psh punimet parket druri, shresë dërrasë FM 2.5 cm dhe shirit MDF në muret e klasave dhe shtresë dërrase FM 2.5 cm, të zbatohen me sukses.

- **Specialiste për sisteme ngrohje-ftohje 3 (tre)** janë të nevojshëm pasi punimet e sistemit të ngrohjes zënë një pjesë të konsiderueshme në zërat e preventivave të punimeve.

Duke marrë në konsideratë faktin se punimet për sistemin ngrohje-ftohje do të kryhen për 8 javë (rreth 2 muaj) (sipas grafikut të punimeve), njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal për punonjësish specialistë për sisteme ngrohje-ftohje.

Konkretisht, Pajisjet sistemi i ngrohjes rreth 6 477.72 orë punë (sipas tabelës nr 1).

Nga përllogaritja e mësipërme, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal punonjësit me dëshmi kualifikimi për specialist për sisteme ngrohje-ftohje, duke garantuar autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

Edhe pse numri i orëve të punëve për punime ngrohje është relativisht i lartë, njësia e prokurimit argumenton se disponimi i një numri minimal prej 3 (tre) punonjësish nga ofertuesit, krijon bindjen dhe sigurinë e autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë. AK është në të drejtën e tij të parashikoj kritere minimale kualifikuese.

- **Teknik /Specialist Elektronik/IT** është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve si instalimi i rrjetit të telekomunikacionit së bashku me linjat e internetit dhe sistemin e survejimit me kamera, për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësive Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR. **minimalisht** si më poshtë:

- Eskavatorist 1 (një)
- Automakinist 1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtime dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

** Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e kërkuar si me sipër, emer/mbiemer, numrin dhe datën e dëshmive së aftësisë profesionale.*

****(Në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera, këta punonjës (eskavatorist dhe automakinist) lejohet të plotësohet edhe nëpërmjet kontraktimit).***

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht VKM Nr. 629 Datë 15.07 2015“Për Miratimin E Manualeve Teknike Të Çmimeve Të Punimeve Të Ndërtimit Dhe Të Analizave Teknike Të Tyre” (i ndryshuar).

Eskavatorist 1 (një) është i nevojshëm për punimet me eskavator dhe minieskavator ku përfshihen gërmimet sipas zërave të preventivit.

Automakinist 1 (një) është i nevojshëm për përdorimin e autovinçit, ngeshës/kompaktor etj, në përputhje me zërat e preventivit.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë minimalisht në listëpagesat e muajit të fundit, punonjës të specializuar/të kualifikuar si më poshtë :

- 1 (nje) punonjës të pajisur me çertifikatë si “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

** Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësin e kërkuar si më sipër, emër/mbiemër, numrin dhe datën e çertifikatës, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument.*

- 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10 327 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores”, “Për sigurinë në kantier”. Për përmbushjen e këtij kushti duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e lëshuar nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

** Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësin e kërkuar si më sipër, emër/mbiemër, numrin dhe datën e çertifikatës, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument.*

E-4.10	Analize	F. Pompe riqarkullimi kt 1 Karakteristikat Teknike: - Prurja: 10 m ³ / h - Prevalenca: 7 mkH ₂ O - Lidhjet: DN40 / PN 10 - Fuqia elektrike 0.37kW - 3-400v/50Hz	cope	1.00	2	2.00
E-4.11	Analize	F. Pompe riqarkullimi kt 2 Karakteristikat Teknike: - Prurja: 11 m ³ / h - Prevalenca: 8 mkH ₂ O - Lidhjet: DN40 / PN 10 - Fuqia elektrike 0.55kW - 3-400v/50Hz	cope	1.00	2	2.00
E-4.12	Analize	F. Pompa e qarkullimi Kaldaje-ndares hidraulik - Prurja: 43 m ³ / h - Prevalenca: 5 mkH ₂ O - Lidhjet: DN 50 / PN 16 - Fuqia elektrike 0.75kW - 3-400v/50Hz	cope	1.00	2	2.00
E-4.13	Analize	F. Pompa e kondenses se kaldajes Karakteristikat Teknike: Karakteristikat Teknike: - Prurja: 10 m ³ / h - Prevalenca: 1 mkH ₂ O - Lidhjet: Ø 2" / PN 10	cope	1.00	2	2.00
E-4.14	Analize	F. Rezervuari i gazit Depozitë horizontale dopio paret - Kapaciteti 1000 lit;	cope	2.00	2	4.00
E-4.16	Analize	F. Ndares hidraulik	cope	1.00	1	1.00
		Ore pune total				77,802.94
A		Dite pune duke llogaritur 8 ore ne dite				9,725.37
B		Afati ne muaj				7 muaj
C		Afati ne dite pune				182

D		Nr i punonjesve per periudhen e caktuar				53.4
----------	--	--	--	--	--	-------------

Bazuar nga tabela e mësipërme, njësia e prokurimit sqaron se totali i orëve të punë që duhet për të zbatuar kontratën me sukses, nevojiten 77 802.94 orë punë të cilat janë kryer sipas manualit teknik.

77 802.94 orë pune totali : 8 ore në ditë (që lejohet të punohet sipas kodit të punës) = 9 725.37 ditë (që të kryhet ky investim)

Kohëzgjatja e punimeve është 7 muaj. 26 ditë punë në muaj (maksimumi që lejohet) x 7 muaj = 182 ditë pune

Në total duhet 9 725.37 (orë pune për 1 person) : 182 ditë punë (që është grafiku i punimeve) = 53.4 punonjës.

Nga përlllogaritja e mësipërme, njësia e prokurimit ka miratuar kriterin për 53 (pesëdhjetë e tre) punonjës të nevojshëm për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

2.3.11 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, mjedisit, energjisë dhe të shëndetit e sigurisë në punë. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- **ISO 9001 - 2015** (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) *ose ekuivalent*
- **ISO 14001 - 2015** (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor) *ose ekuivalent*
- **ISO 45001 - 2018** (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) *ose ekuivalent*
- **ISO 50001 - 2011** (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë) *ose ekuivalent*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Për vetë natyrën e veçantë dhe delikate, dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet si dhe afatit për zbatimin e saj.

Kjo certifikatë lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohet edhe certifikata ekuivalente të tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të

operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardin për menaxhimin e mjedisit për sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtëpërdrejtë në mjedis.

ISO (Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit) është një organizatë me anëtarësi e pavarur, jo-qeveritare dhe zhvilluesi më i madh në botë i Standardeve Ndërkombëtare, nga 163 vende të botës. ISO publikon më shumë se 19500 Standarde Ndërkombëtare, të cilat mbulojnë pothuajse çdo fushë industrie, nga teknologjia te siguria ushqimore, bujqësia e shëndeti. Në nivel botëror shoqëritë ndjekin adoptimin e standarteve të cilësisë me qëllim që të jenë të respektuar nga klientet e autoritetet shtetërore dhe të ndërtojnë bashkëpunim të qëndrueshëm me avantazhe reciproke.

➤ **ISO 9001- 2015** (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) **e vlefshme, ose ekuivalent**

Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të cilësisë, është **standarti më i njohur që është publikuar ndonjëherë në nivel ndërkombëtar**. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, preventivin dhe vlerën e saj, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkojë certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, që përpos punimeve që do të kryhen nga operatorët ekonomik ofertues, këto punime të kryhen me cilësi sipas certifikatës iso të mësipërme .

➤ **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të ambientit” **e vlefshme, ose ekuivalent**

Ky çertifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit mjedisor, me anë të së cilës garantohen mundësitë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një subjekti me synim parandalimin e dëmtimit të mjedisit, respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me mjedisin dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Gjithashtu, ky çertifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të subjektit, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në aspektin mjedisor .

Kjo certifikat është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Referuar objektit të prokurimit në rastin konkret, njësia e prokurimit e ka parë të nevojshme që shoqëritë të jenë të çertifikuara nga organizata ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit të mjedisit sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim

të drejtpërdrejtë mbi të, duke kryer një proces riaftësimi më pas të ambientit përreth ku do të kryhet investimi.

➤ **ISO 45001-2018** (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme) **e vlefshme, ose ekuivalent**

Është dokumenti i njohur në mënyrë zyrtare në nivel ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurimit në punë .

Kjo certifikatë garanton sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve që marrin pjesë gjatë një procesi prodhimi apo kryerjes së një veprimtarie apo pune publike e cila vë apo mund të vërë në rrezik shëndetin dhe jetën e punonjësve . Është e lidhur ngushtë dhe në përpjestim me objektin e kontratës, sipas parashikimeve të LPP.

Autoriteti kontraktor përpos punimeve që do të kryejë, kërkon që këto punime ti zhvillojë në përputhje dhe garanci të plotë me sigurinë dhe shëndetin në punë të punonjësve .

➤ **ISO 50001:2011** (**Sistemi i Menaxhimit të Energjisë**) **e vlefshme, ose ekuivalent**

Kjo ISO përfaqëson standartin për menaxhimin e sistemit të energjisë dhe specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, ruajtjen dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të energjisë, qëllimi i të cilit është për të mundësuar një organizatë për të ndjekur një qasje sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, duke përfshirë efikasitetin e energjisë, përdorimin e energjisë dhe konsumit të saj .

Në preventivin e punimeve të procedurës së prokurimit është parashikuar edhe kryerjen e punimeve elektrike si dhe punimeve për ngrohje. Referuar zërave të Preventivit parashikohet edhe furnizim vendosje e paisjeve elektrike si “kabuj, ndriçues, shtylla elektrike, panele të matjes së energjisë, automate etj.

Në rastin konkret synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se operatori ekonomik dhe prodhuesit e produkteve të ofruara prej tyre ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë. Nga analiza e mësipërme konstatohet se kërkesa e autoritetit kontraktor për dorëzimin e certifikatave standarte ISO të operatorëve ekonomikë dhe prodhuesit e produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë, sipas fushave përkatëse të certifikimit ISO (ISO 50001:2011 “Për menaxhimin e energjisë”) është një kërkesë proporcionale me objektin e prokurimit përse kohë që në preventivin e punimeve të procedurës së prokurimit janë parashikuar kryerjen e punimeve elektrike. Kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor nuk shkon përtej asaj çka është e nevojshme për të arritur synimin bazë, vërtetimin se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dhe prodhuesit e produkteve të ofruara prej tyre ushtrojnë veprimtarinë e tyre në

përputhje me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit/cilësisë, në zbatim të LPP-së.

2.3.12 Operatorët ekonomik ofertues për realizimin me sukses të kontratës, duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet teknike si më mëposhtme :

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbi 10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Kamioncine me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Kamioncine me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Kamioncine me vinc me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Autovinc me kapacitet ngritës mbi 5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Eskavator	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Ngjeshes/ kompaktor	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Total station	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Motogjenerator / Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Depozite uji 5000 litra	në pronësi ose me qira	Copë 2
13	Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 5
14	Vidiator	në pronësi ose me qira	Copë 2
15	Trapan	në pronësi ose me qira	Copë 2
16	Nivelues me lazer	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Aparat lidhje per fiber optike	në pronësi ose me qira	Copë 1

18	Freze per rrafshim/hapje kanalesh ne mur	në pronësi ose me qira	Copë 1
19	Pompë uji	në pronësi ose me qira	Copë 2
20	Betoniere	në pronësi ose me qira	Copë 2
21	Skela metalike të kompletuara	në pronësi ose me qira	Min 500 m2
22	Kompresor ajri	në pronësi ose me qira	Copë 2
23	Makineri/Pompe lyerje	në pronësi ose me qira	Copë 1
24	Pompë presioni për testimin e tubave nën presion	në pronësi ose me qira	Copë 2
25	Pajisje/Makineri për bashkimin e tubave PPR	në pronësi ose me qira	Copë 1
26	Pajisje/Makineri për bashkimin e tubave PEX	në pronësi ose me qira	Copë 2
27	Saldatrice/Motosaldatrice	në pronësi ose me qira	Copë 1

Për përmbushjen e kesaj pikës, operatorët ekonomikë ofertues duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve të mësipërm në përputhje me shtojcën 8.

- a) *Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik si dhe çertifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme), siguracionin e mjetit (të vlefshme).*
- b) *Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), çertifikatën e kontrollit teknik si dhe çertifikatën e transportit të mallrave (të vlefshme), siguracionin e mjetit, (të vlefshme) duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*

Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- c) *Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre,apo marrjen me qira te tij.*
- d) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës përkatëse. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*

- e) *Operatori ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara më sipër do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet përgjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak për skualifikim. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës .*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar ligjvënësi i jep të drejtën autoritetit kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomik dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve të ndërtimit dhe preventivit të hartuar, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve. Për realizimin e kontratës me sukses dhe në kohë autoriteti kontraktor kërkon garanci nga operatorët ekonomik ofertues të cilët duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme, gjithçka në funksion të zbatimit të kontratës.

Duke parë volume e punimeve, afatin për realizimin e saj, vlerën e kontratës, relacionin teknik është e nevojshme që operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se disponojnë mjetet e mësipërme për realizimin me sukses dhe në kohë të objektit të prokurimit .

Analizë të detajuar në lidhje me mjetet dhe pajisjet teknike që kërkohen nga autoriteti kontraktor :

- **Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbi 10 ton (1 copë) dhe kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 ton (2 copë);** Kërkohen kamionat pasi kemi transport të lëndëve inerte, si dhe transporti i volumeve që dalin nga punimet e gërmimit për shtresat rrugore në sheshin e objektit, prishje struktura betoni etj.

Duke analizuar preventivin e punimeve janë parashikuar punime prishje në volume të mëdha (punime prishje dhe çmontimi), si Prishje suvatim i brendshëm në sasinë 3750 m², Prishje suvatim i tavanëve në sasinë 1650 m² Prishje shtresa pllaka çimento në sasinë 1880 m², Prishje

bazmak shkallësh në sasinë 60 m², Prishje veshje ma pllaka majolike në sasinë 350 m², heqje shtrese hidroizolim dhe nënshtresat + transport mbeturish deri në 5 km në sasinë 687 m², prishje çe ekzistuese në sasinë 841 m², si dhe transportimi mbeturina deri 4 km në sasinë 230 m³.

Mjetet e mësipërme janë parashikuar (punime sistemime të jashtme) dhe për transportimin e mbetjeve nga Germim dheu kanal me makineri + transport 5km (sheshi parashkollës, rrjeti KUB dhe KUZ në sasinë 135 m³, si dhe Germim dhe transport dheu për kanalet e tubove dhe pusetave në sasinë 50 m³ (rrjeti i shpërndarjes së ujit sanitar).

Ato do të përdoren edhe për transportimin e materialeve pranë kantierit të ndërtimit për punimet për sistemime të jashtme si psh, Shtrese Cakelli mbeturina kave t = 20 cm perhapur e ngjeshur me makineri në sasinë 600 m², mbushje me çakull dhe gur gurore përhapurt e ngjeshur me makineri (mbushje të kanalit KUB dhe KUZ në sasinë 62 m³, Shtrese rëre (për mbulim të KUB, KUZ dhe shehin përpara shkollës në sasinë 38 m³.

Duke analizuar proceset e punës sipas preventivit të punimeve dhe më sipër argumentuar, njësia e prokurimit gjykon se ka kërkuar një numër minimal mjetesh në krahasim me volumet e punës që do të kryhet. Por duke qënë se këto procese pune mund të zgjaten edhe gjatë gjithë afatit të zbatimit të punime (që është 7 muaj), kërkesa e mësipërme i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor dhe është në përputhje dhe vëllim të plotë me objektin e kontratës.

- **Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 deri në 5 ton** ; prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe proceseve si transporti i materialeve, tjegulla, pllaka etj.

Duke analizuar preventivin e punimeve, këto mjete shërbejnë për transportimin e tjegullave në përputhje me zërin çati vendi e zakonshme Hd ~ 8 m mbuluar me tjegulla vendi në sasinë 841 m² për rikonstruksionin e shkollës.

Një tjetër proces i rëndësishëm që do të kryej mjeti i mësipërm, është dhe transportimi i materialeve si pllaka guri (shtrimi i sheshit dhe trotuarit përreth) në sasinë 610 m³, FV bordure betoni 15x30 cm (në perimetrin e shkollës) në sasinë 120 ml, bordurë betoni 6x20 (kornizat e pemëve) në sasinë 40 ml etj.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se referuar punimeve të sipërcituar të cilat janë në volume të mëdha, kërkesa për disponimin e një kamionçine me kapacitet mbajtës 3.5 deri në 5 ton, është një kërkesë minimale dhe i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor.

- Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton; prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe proceset si transport i mbeturinave, materiale hidraulike elektrike etj. Ky mjet është i favorshëm pasi mund të qarkullojë në çdo orar.
- Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton me vinç; prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe proceset si transportin dhe ngritjen me vinç të materialeve të imëta si hidraulike, elektrike etj.
- Autovinç me peshë ngritëse mbi 5 ton; prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit dhe konsiston në ngritjen e materialeve të rënda sipas kërkesave dhe nevojave të projektit. Kërkesa e mësipërme shërben për ngritjen e materialeve në katin e dytë, si dhe në çatinë e objektit.
- Eskavator; Kërkohet për gërmime dhe mbushje të shtresave rrugore dhe mbeturinave.
- Minieskavator; Kërkohen për gërmime të vogla të cilat do të bëhen në shesh për kanalizimet dhe kullimet e ujrave.
- Ngjeshes/ kompaktor; është i nevojshëm për ngjeshjen e trotuareve në sheshin e shkollës.
- Total station dhe; kërkohet pasi kemi matje topografike përsa i përket rlevimeve dhe sistemimeve të jashtme.
- Motogjenerator/Gjenerator; prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht në momente kur nuk kemi energji elektrike.
- Depozite uji 5000 litra (2 copë); janë të nevojshme në rastin kur ka mungesë të furnizimit me ujë, kur duhet bërë llaçi për suvatimet, kolla për shtrimin e pllakave, ujitja e rrugës dhe e bimëve e do të mbillen etj.

- Matrapik (5 copë) ; prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, konkretisht për prishjen e ndertimeve, heqjen e shtresave të betonit etj.
- Vidiator (për kapjen pllakave të gipsit) (2 copë), Trapan (2 copë), Nivelues me lazer; prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, si ndërtimin e tavaneve me kartonxhes.
- Aparat lidhje për fibër optike; është i nevojshëm për të bërë shkrirjen e fibrave optike në një të vetme.
- Freze për rrafshim/hapje kanalesh në mur; prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit, konkretisht në hapjen e kanaleve në mur për kalimin e tubove dhe telave elektrik.
- Pompë uji (2 copë); prezenca e tyre në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me nevojën për ngritjen e ujit me pompë në katet e larta në rast se ka mungesë furnizimi.
- Betoniere (2 copë); prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me nevojën për gatitje llaçi për shtresën e llustrës së çimentos, llaç suvatimi etj.
- Skela metalike (formë H) të kompletuara; Kërkohet skelë metalike pasi kemi punime në lartësi në të gjithë sipërfaqen e fasadës.

Duke qënë se shkolla ka sipërfaqje të madhe ndërtimi, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa për disponimin nga ana e ofertuesve për 500 m² Skela metalike, është në përputhje me objektin e kontratës si dhe i shërben qëllimit të AK duke garantuar këtë të fundit për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë.

- Makineri/Pompë lyerje; prezenca e saj në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë bëhet për shkak të efikasitetit të kërkuar, për të mbyllur në kohë procesin e lyerjes.
- Pompë presioni për testimin e tubave nën presion (2 copë); prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo vegël mundëson testimin e lidhjeve të tubave të ndryshëm në godinë dhe presionin nominal që kalon te tubat.
- Pajisje/Makineri për bashkimin e tubave PP; prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo vegël mundëson ngjijtjen tubove PP sipas zerave të preventivit.
- Pajisje/Makineri për bashkimin e tubave PEX (2 copë); prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo vegël mundëson ngjijtjen tubove PEX sipas zërave të preventivit.
- Saldatriçe/Motosaldatriçe; prezenca e tij në kantieret e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses. Kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit konkretisht për saldimin e tubove kangjellave, profileve metalike etj.

2.3.13 Operatori/et ekonomike ofertues për materialet :

- Hidroizolues me bazë cimento
- Astar për Hidroizolues
- Llac për mbushje dhe suvatim
- Bojë hidroplastike
- Profile për dritare dhe dyer plastike
- Pllaka gipsi me fiber minerare për tavanin e varur (60cm x 60cm)
- Pllaka gipsi (për tavanin me kartonxhes)
- Sistem kapote (Termoizolimi me polisterol)

- Parket druri
- Detektorë (Sensorë) tymi
- Sirena alarmi
- Kaldajë me gaz (110kw)
- Elementë radiatori
- Tuba te brinjëzuar HDPE SN8 d=200mm; SN8 d=315mm
- Tuba e rakorderi ujesjellesi PP-R, Ø40 PN16
- Tuba PEX (Ø16 X 2.0) mm, i termoizoluar

Për rastet kur operatori ekonomik ofertues nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi, ose distributori të autorizuar. ose marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të noterizuar e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit **ose midis ofertuesit - distributor-prodhues**, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: Adresë, telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.

Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi.

Për materialet :

- **Llaç për suvatim**
- **Bojë hidroplastike**

Operatori ekonomik ofertues **nëse nuk është prodhues** duhet të paraqesë raportet/çertifikatat e testimit nga laboratorë të çertifikuar sipas standartit ISO/IEC 17025 ose ekuivalent.

Përsa i përket bojës hidroplastike, operatori ekonomik ofertues **nëse nuk është prodhues** duhet të paraqesë raportet/çertifikatat e testimit **nga prodhuesi ose distributori** ku të vërtetohet se produkti është antimikrobial (*që vepron kundër mikroorganizmave* dhe ekologjik (EU ECO Label), ose ekuivalente të lëshuara nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare të akreditimit.

Për materialin:

- **Pllaka gipsi me fiber minerare per tavanin e varur (60cm x 60cm)**

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ose deklarata e konformitetit ne perputhje me standartin SSH: EN EN 15283 *ose* ekuivalente nga institucione

kombëtarë ose ndërkombëtare të akreditimit (*Përsa i përket rezistencës së pllakave te gipsit me fiber minerare*).

Për materialin:

-Pllaka gipsi (per tavanin me kartonxhes)

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të certifikuar ose deklarata e konformitetit ne perputhje me standartin SSH: EN 520 ose ekuivalente nga institucione kombëtarë ose ndërkombëtare të akreditimit (*Për pllakat e kartonit dhe gipsit*).

Për materialin:

-Sistem kapote (Termoizolimi me polisterol)

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të certifikuar ose deklarata e konformitetit ne perputhje me standartin EN 13499 ose ekuivalente (*përsa i përket izolimit termik per ndërtesa*).

Për materialin:

-Parket druri

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të certifikuar ose deklarata e konformitetit ne perputhje me standartin EN 14342 ose ekuivalente (*përsa i përket dyshemeve dhe parketit prej druri*).

Për materialet:

-Detektorë (Sensorë) tymi

-Sirena alarmi

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të certifikuar ose deklarata e konformitetit ne perputhje me standartin EN 54 ose ekuivalente (*përsa i përket sistemeve të zjarrit dhe alarmit*).

Për materialin:

-Kaldajë me gaz (110kw)

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të certifikuar e perputhje me standartin EN 15502 ose ekuivalente (*përsa i përket sistemeve te ngrohjes me kaldaje gazi*).

Për materialin:

-Elemente radiatori

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ose deklarata e konformitetit ne perputhje me standartin EN 442 ose ekuivalente (*sipas standartit europian për ngrohjen me radiatorë*).

Për materialin:

-Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=200mm; SN8 d=315mm

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ose deklarata e konformitetit ne perputhje me standartin EN 13476 ose ekuivalente (*persa i perket sisitemeve te tubove plastike per kanalizime dhe kullime pa presion*).

Për materialin:

-Tuba e rakorderi ujesjellesi PP-R, Ø40 PN16

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ose deklarata e konformitetit ne perputhje me standartin EN 15874 ose ekuivalente (*persa i perket sisitemeve te tubove plastike per instalimet e ujit te ngrohje dhe te ftohte*).

Për materialin:

-Tuba PEX (Ø16 X 2.0) mm, i termoizoluar

Duhet te paraqiten certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ose e perputhje me standartin EN 1420 ose ekuivalente (*persa i perket kushteve higjeno-sanitare qe garantojne keto tuba*).

Persa i perket tubove PP-R dhe PEX, Operatori ekonomik ofertues **nese nuk eshte prodhues** duhet te paraqese raportet/certifikatat e testimiit **nga prodhuesi ose distributor** te leshuara nga institucione kombetare ose nderkombetare te akreditimit, ku te vertetohet se produktet jane per perdorim per uje te pijshem.

(Nëse nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit.)

(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik pikat e kriterit të mësipërm duhet të plotësohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Argumentim : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, si dhe”, në bazë të nenit 44, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kjo kërkesë është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe materialet e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kerkuara prodhohen në mënyrë industriale, çertifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të verifikojë që specifikimet teknike të paisjeve të propozuara nga operoret ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si : çertifikatë/deklaratë konfirmimiteti, çertifikatat e cilësisë ose raportet e testimi nga labororë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike.

Kërkesa për dorëzimin e formatit të autorizimit të prodhuesit dhe katalogëve për produktet e sipërcituara është një kërkesë në përputhje dhe proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës dhe i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor, nuk krijon pengesa të dukshme ose të fshehura për ofertuesit si edhe nuk diskrimininon midis operatorëve ekonomikë ofertues vendas dhe të huaj, pasi standartet e kërkuara është Standardi Shqiptar i cili është i harmonizuar me Standardin European.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet dhe furnizimet që parashikohen të realizohen në preventiv, duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve bashkëkohore. Prandaj e gjykojmë të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve europiane, në mënyrë që të provohet që operatori ekonomik ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Me anë të vënies në dispozicion në fazën e ofertimit të dokumentave si autorizim-marrëveshje angazhimi, skeda teknike, çertifikata cilësie, çertifikata konformiteti dhe raporte testimi, ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë në përputhje sipas kërkesave të projektit.

2.3.14 Operatori ekonomik përsa i përket pllakave të gurit për shtrimin e sheshit të shkollës, në përputhje me kushtet teknike dhe preventivin përkatës, në rast se nuk e disponon në pronësi duhet të paraqesë kontratë furnizimi ose autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar.

Përsa me sipër duhet të paraqitet:

- Kontrata e furnizimit ose autorizimi nga prodhuesi/distributor
- Certifikata/test raporti nga laboratorë të çertifikuar ose deklarata e konformitetit në përputhje me standartin EN 1926 ose ekuivalente (*për përcaktimin e rezistencës në shtypje persë i perket pllakave të gurit*).

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik duhet të plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatoreve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Bazuar dhe në preventivin e punimeve, specifikimeve teknike dhe relacionit teknik, kërkesa e autoritetit kontraktor për disponimin nga ana e operatoreve ekonomik për aktivitetin “Prerje, gdhendje dhe lustrimi i gurit”, në vetvete nuk është një kriter diskriminues dhe i pamundur për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret është në të drejtën e autoritetit të kërkojë garanci lidhur me mundësitë e operatoreve ekonomik për sigurimin e lëndës bazë dhe materialeve që do të përdoren për realizimin e objektit, përse kohë lejohet provueshmëria e disponimit nëpërmjet edhe kontratave të furnizimit sikurse autoriteti kontraktor ka përcaktuar në DST, duke e lenë të hapur përmbushjen e këtij kriteri në respekt të plotë të ligjit të prokurimit publik.

Kërkesa e mësipërme është vlerësuar e nevojshme pasi i gjithë sheshi i shkollës do të shtrohet me pllaka guri të prera. Gjithashtu duke patur parasysh se guri natyror është një material që i reziston viteve dhe kushteve klimatike të ndryshme, investitori dhe projektuesi kanë vendosur përdorimin e tij për shtrimin e sheshit të shkollës. Bazuar në këto cilësi në mënyrë që investimi të jetë sa më afatgjatë, si dhe duke qenë se në preventiv dhe projekt janë parashikuar rreth 610m²

shtrim me pllaka guri, njësia e prokurimit gjykon se disponimi nga ana e ofertuesve të kontratës së bashkëpunimit me një subjekt të licencuar sipas legjislacionit shqiptar për furnizimin me pllaka guri është në përputhje me objektin e prokurimit dhe garanton njëkohësisht autoritetit kontraktor për zbatimin e punimeve me sukses dhe në kohë.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT